

**UDHËZIM**  
**Nr.8, datë 2.2.2011**

**PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT TË DUBLIKATAVE PËR PËRFUNDIMIN E**  
**ARSIMIT TË MESËM**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 63 dhe 64 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”,

**URDHËROJ:**

1. Për personat që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe nuk disponojnë dëftesën e pjekurisë, të ndiqet procedura më poshtë:

a) Kërkuesi të depozitojë kërkesën në drejtorinë arsimore rajonale (DAR) ose zyrën arsimore (ZA) që mbulon shkollën ku kërkuesi ka përfunduar arsimin përkatës, për t’u pajisur me një dëftesë pjekurie (dublikatë).

b) DAR/ZA të përcjellë kërkesën te shkolla e mesme.

c) Dëftesa e pjekurisë (dublikatë) të plotësohet nga drejtori i shkollës sipas përcaktimeve në këtë udhëzim dhe t’i përcillet zyrtarisht DAR/ZA-s.

d) DAR/ZA ta legalizojë sipas procedurave për dokumentacionin që destinohet jashtë shtetit dhe ta dërgojë në MASH.

e) Dëftesa e pjekurisë (dublikatë) të legalizohet sipas udhëzimeve përkatëse në MASH.

f) Kërkuesi ta tërheqë dëftesën e pjekurisë (dublikatë) vetëm në MASH.

2. Në rast se shkolla ku kërkuesi ka përfunduar studimet është mbyllur, të ndiqet procedura më poshtë:

a) Pas marrjes së kërkesës, DAR/ZA kryen verifikimin pranë institucionit ku mbahet dokumentacioni zyrtar i shkollës përkatëse.

b) Bazuar në rezultatin e verifikimit, DAR/ZA plotëson dëftesën e pjekurisë (dublikatë) për kërkuesin, e cila firmoset dhe vulolet nga drejtori i DAR/ZA-së.

c) Në vijim veprohet sipas përcaktimeve në pikën 1/d, 1/e dhe 1/f të këtij udhëzimi.

3. Në rastet kur një autoritet i huaj kërkon konfirmim të përfundimit të studimeve për një individ në një cikël të caktuar parauniversitar sipas një formulari të caktuar, plotësimi dhe konfirmimi zyrtar të bëhet nga MASH-i. Procedura e verifikimit të kryhet nga DEPU (MASH), ndërsa plotësimi dhe konfirmimi zyrtar të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i MASH-it.

4. Dëftesat e pjekurisë (dublikatë), përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të lëshohen sipas formatit standard të dëftesës së pjekurisë, me ndryshimet e mëposhtme:

a) Në faqen e parë, poshtë fjalëve “Dëftesë pjekurie”, të shkruhet “Dublikatë” me të njëjtën tip dhe përmasë germe.

b) Në faqen e dytë, te kolona e lëndëve, të mos shkruhen lëndët, por këto të plotësohen me shkrim dore sipas planit mësimor të shkollës.

c) Te kolona “Lëndët mësimore” të krijohen 30 rreshta për të përfshirë maksimumin e mundshëm të numrit të lëndëve për disa tipa shkollash.

5. Kjo procedurë zgjat deri 15 ditë nga data e depozitimit të kërkesës dhe kërkuesi paguan vetëm tarifën standarde të legalizimit në MASH.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, DSHP-ja dhe DEPU-ja për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**